

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUJË

Nr. 6606 .Prot

Kruje, më / 08/11 .2017

KONTRATE SIPËRMARRJE

PËR OBJEKTIN


”Rikonstrukcion i Shkollës e Bashkuar, Borizanë + Palester”

PALET KONTRAKTORE

**AUTORITETI KONTRAKTOR:
BASHKIA KRUJË**

Z. Artur BUSHI

Kryetari i Bashkisë



KONTRAKTUESI:

“Regli” sh.p.k dhe “Agi Kons” sh.p.k

Z. Mjazi Prençi

Z. Alban Cinari



**AGI KONS
SH.P.K.
TIRANË**

Administratori



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUIJË

Lidhur sot me datë ____/____/2017, ne baze te nenit 850 e ne vazhdim te Kodit Civil , Ligjit nr 9643 date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, Nenit 30 si dhe VKM nr 914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregulave te Prokurimit Publik” , kreu IV neni 33 midis paleve si vijon:

Bashkisë Kruijë te perfaqesuar nga Kryetari **Z. Artur Bushi** , perfaqesues i vetem ne rolin e investitorit, qe me poshte do te quhet Autoritet Kontraktor.

Dhe :

Shoqerise : Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Regli”sh.p.k me adrese ne Tirane, Njesia Bashkiake nr.2 me NIPT K48021206L, me administrator Njazi Prenci dhe “Agi Kons” sh.p.k me adrese ne Tirane, Farke, Selite Kofra e Diellit II, me NIPT K21622001M me administrator Alban Cinari ,qe me poshte do te quhet kontraktues.

Neni 1

Objekti i Kontrates

Objekti i kesaj kontrate eshte sipermarrja e punimeve te ndertimit me objekt, ” Rikonstruksion i Shkollës e Bashkuar, Borizanë + Palester ” .


“

Neni 2

Vlefte e kontrates .

2.1-Kontrata lidhet me nje vlere totale prej 61.478.539 (gjashtedhete e nje milion e katerqind e shtatedhete tete mije e peseqind e tridhjetete e nente) leke pa t.v.sh dhe 73’774’247 (shtatedhjetete e tremilion e shtateqind e shtatedhjetete e kater mije e dyqind e dyzet e shtate) leke me t.v.sh. Vlera e likuidimit për vitin 2017 është 24’719’189 (njezet e kater milion e shtateqinde e nëntëmbëdhjetete mije e njeqinde e tetëdhjetete e nente) leke pa t.v.sh dhe 29’663’027 (njezet e nente milion e gjashteqind e gjashtedhjetete e tre mije e njezet e shtate) leke me t.v.sh ndersa pjesa e mbetur do të likuidohet ne vitin 2018 ..

2.2-Cmimet e kontraktorit per punet e kryera sipas kontrates nuk duhet te ndryshojne nga cmimet e ofruara nga kontraktori ne oferten e tij, sipas preventivit fitues te tenderit te zhvilluar n.09.2017.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUJË

3.1 Afati maksimal i perfundimit te punimeve eshte 90(nentedhjete) dite duke nisur nga data e nenshkrimnit te kesaj kontrate.

Neni 4 Gjuha e Kontrates

4.1-Gjuha ne te cilen perpilohet kjo kontrate eshte shqip.

Neni 5 Perkufizime

“Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.

“Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njësi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.

“Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.

“Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

“Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

“Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

“Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.

“Data e fillimit” eshte perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.

“Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.

“Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.

AGI KONTRAKTOR
SH.P.K.
TIRANE - ALBANIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUJË

“Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

“Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.

“Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

“Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.

“Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.

“Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.

“Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.

“Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

“Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndërtimit të perkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

“Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 6 Prona Intelektuale

6.1 Me përjashtim të kushteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.



AG SH. PAKONS
TIRANE - ALBANIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUIJË

- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7

Mbikqyresi i punimeve

7.1-Bashkia Kruje ne cilesine e autoritetit kontraktor ne mbeshtetje te_Udhezimi nr. 3 date 15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", i ndryshuar me udhezimin nr.1 date 16.6.2011.Ligji nr 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar , neni 850 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise , ligji nr.8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve ne ndertim" i ndryshuar, VKM Nr.759, date 12.11.2014 "Per licensimin profesional te individeve dhe subjekteve juridike qe do te ushtrojne veprimtari ne fushen e studimit e te projektimit ne ndertim dhe mbikeqyrjes e kolaudimit te punimeve te zbatimit ne ndertim" si dhe Ligjit nr 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, do ti komunikojte sipermarresit mbikqyresin e punimeve, me qellim dorezimin e sheshit te punimeve sipas rregullave ne fuqi.

7.2-Sipermarresi duhet te filloje punimet brenda 5(pese) diteve nga komunikimi i mbikqyresit.

Neni 8

Origjina e Materialeve

8.1-Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

8.2- Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.

8.3-Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë prodhuar ose prodhuar, materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së



AGJ...
SH...
TIRANE - ALBANIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUJË

13.2-Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 14

Kontraktori që Kryen Punimet

14.1- Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

14.2- Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

14.3-Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 15

Ekzekutimi i Punimeve

15.1- Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 16

Ngritja e Kantierit

16.1- Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

16.2- Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 17

Sigurimi Teknik dhe Mjedisor


17.1- Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

18.2-Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rrezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 18

Zbulimet

18.1-Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të verifikuar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të informojë drejtuesin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUIJË

projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 19 Disponimi i Kantierit

19.1-Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni: 20 Raportimi i Grafikut të Zbatimit

20.1-Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

20.2-Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 21 Paralajmërimi në Kohë

21.1- Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 22 Kontrolli i Cilësisë

22.1- Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

22.2-Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

22.3-Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

22.4-Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 23

AGI
SH. P. K.
TIRANË - ALBANIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUJË

Defektet e Pakorrigjuara

23.1-Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarise koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

Neni 24

Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor

24.1-Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit te Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

Neni 25

Përgjegjësitë e kontraktorit

25.1-Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas 24.

Neni 26

Sigurimi

26.1- Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në Afatin e Realizimit të Plote, në shumën e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të Punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

26.2-Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrisë koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

26.3-Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.



AGI
SH.P.
TIRANE - ALBANIJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUIJË

Neni 27

Testimet dhe Inspektimet

27.1- Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës

27.2-Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspektime.

27.3-Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspektime shpesh të parashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

27.4-Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

27.5-As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 28

Garancitë

28.1- Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

28.2-Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 29

Çmimi i Kontratës

29.1-Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 30

Kushtet e Pagesës

30.1-Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.



AG / SH.P
TIRANE - ALBANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUIJË

30.2-Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratës, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqipërisë në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

30.3-Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqese nje deklarate me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është permbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së egzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korrjimit të një defekti.

30.4-Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë Punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.

30.5-Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.

30.6-Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 31

Vonesa në Bërjen e Pagesës

31.1-Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bere llogaritja e tyre.

31.2-Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori (kontraktori) te provojendonje dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar nje dem me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

Neni 32

Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

32.1-Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.



AGI

SH.P.

IRANE-AL



REPUBLICA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUJË

Neni 33
Forca Madhore

33.1 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

33.2-Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

33.3-Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 34
Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

34.1-Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

34.2-Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

34.3-Autoriteti Kontraktor mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

34.4-Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

34.5-Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Neni 35
Dëmet Likuidueshme për Vonësën në Mbarimin e Punës



AGI
SH. P. K.
TIRANE - ALBANIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUJË

35.1-Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total I kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 36

Negociatat dhe Amendamentet

36.1-Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.

36.2-Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

36.3-Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 37

Ndryshimi i Porosisë



37.1-Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

37.2-Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

37.3-Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- Korrigjime në projektin vizatimin ose specifikimet e Punëve
- Korrigjime në materiale
- Korrigjime në sasi

37.4-Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUIJE

përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marreveshjes.

37.5-Ndryshimi i porosise nuk do te jete i vlefshem nese nuk formalizohet sipas kerkesave te Nenit 36 te ketyre kushteve te pergjithshme.

Neni 38

Preventivi per Njesi ose ne Total

38.1-Kontrata do të përfshijë një Preventiv ne Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv per Njesi nëse është një kontratë me çmim njesie. Nëse është një kontratë me çmim njesie, Preventivi per Njesi do të përmbajë volumet e zerave te ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.

38.2-Preventivi per Njesi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në Preventivin ne Njesi për secilin ze punimesh.

Neni 39

Mbarimi dhe Marrja Përsipër e Ndertimeve

39.1- Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

39.2-Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerrat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

39.3-Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.


Neni 40

Ndërprerja për Mosplotësim

40.1-Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

40.2-Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin që përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.



AGI
SH.P.K.
TIRANE - ALBANIJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUIJË

40.3-Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj.

Neni 41

Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

41.1-Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

41.2-Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 42

Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

42.1-Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

42.2-Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

42.3-Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 43

Nënkontraktimi

43.1-Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.

43.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacinin që provon aftësinë e nën-kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

43.3-Cdo nënkontraktor duhet të ketë të drejtë të marre pjesë në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për punët që do të kryejë

43.4-Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

Neni 44

Transferimi i të Drejtave

AGJ
SH
TIRANE - ALBANIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUJË

44.1- Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 45

Sigurimi i Kontrates

45.1-Përpara nënshkrimit të kontratës, pasi të kene perndunduar procedurat e negociimit, kontraktuesi duhet ti dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar 10% e vleres se preventivit te punimeve ne shumen prej 7'378'000 (shtate million e treqind e shtatedhjete e tete mije) leke.Ne rast se sipermarresi deshton ne dorezimin e sigurimit te kontrates atehere kontrata do konsiderohet e anuluar.

45.2-Shuma e sigurimit te kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

45.3-Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

Neni 46

Baza Ligjore

46.1-Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 47

Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

47.1-Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

47.2-Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 48

Përfaqsimi i Palëve

48.1-Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

48.2-Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

48.3-Palët mund të emërojnë persona ose strukture organizative shtesë për të përfunduar palën në veprime ose veprimtari të lidhura në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUJË

Neni 49
Lajmërimet

49.1-Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

49.2-Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 50
Llogaritja e Afateve

50.1-Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Neni 51
Dsipozita tranzitore

51.1Pjese e kushteve te kesaj kontrate jane e kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te miratuara ne DST perkatese te procedures se prokurimit realizuar nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Kruje si dhe preventive fitues i tenderit te dates 11.09.2017

INVESTITORI

BASHKIA KRUJË

Kryetari

Z, Artur BUSHI



SIPËRMARRESI

BASHKIMI I OPERATOREVE EKONOMIK

“Regli” sh.p.k dhe

“Agi Kons” sh.p.k

Administratori
REGLI

Z, Njazi Prënci
CEL.0672028399

Administratori

Z, Alban Cinari





5/13

Shtojca 18

KUSHTET E VEÇANTA
Punët – Procedura e Hapur

Kushtet e veçanta të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë Kushtet e veçanta të kontratës.

Neni 1: Përkufizime

- 1.1 Autoriteti Kontraktor është :Bashkia Krujë.
- 1.2 Kontraktori është:Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Regli”sh.p.k me adrese ne Tirane, Njesia Bashkiake nr.2 me NIPT K48021206L, me administrator Njazi Prenci dhe “Agi Kons” sh.p.k me adrese ne Tirane, Farke, Selite Kofra e Diellit II, me NIPT K21622001M me administrator Alban Cinari

2. Neni 2: Sigurimi i Kontrates

- 2.1 Sigurimi i kontratës në shumën prej (10% të vlerës së ofertës) duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Sigurimi i kontratës do t’i lëshohet ose kthehet, menjëherë, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm:

Neni 3: Drejtuesi i Projektit

- 3.1 Drejtuesi i Projektit do të jetë: _____
- 3.2 Adresa/pika e kontaktit: _____

Neni 4: Kantieri

- 4.1 Kantieri i Punëve do të jetë (Pershkrimi i saktë i venddodhjes së objektit që do të realizohet):

Neni 5 Data e Fillimit

- 5.1 Kontraktori do t’i jepet leja për të hyrë në kantier më: _____

Neni 6: Sigurimi

(Handwritten signatures and stamps)





- 6.1 Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej:
- a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve: _____
 - b. Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve: _____
 - c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve: _____
 - d. Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier: _____

Neni 7: Inspektimet dhe Testimet

- 7.1 Inspektimet dhe testimet para vërtetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë: _____
- _____
- _____

Neni 8: Lloji i Kontratës

- 8.1 Kjo kontratë do të çmohet si një
- Kontratë me Çmim Njësie të bazuar në çmimet e njësive të shprehura në Preventivin në Njësi
 - Kontratë me Shumë Totale

Neni 9: Grafiku i Pagesës


- 9.1 Pagesa duhet bërë sipas grafikut të mëposhtëm: _____
- _____
- 9.2 Pagesa për Punët duhet bërë brenda _____ ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument që deklaron se objektivi për pagesën është arritur subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga drejtuesi i projektit. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.
- 9.3 Monedha e pagesës do të jetë LEK. Nëse nuk është specifikuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

Neni 10. Pagesa Paraprake

- 10.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse nuk është specifikuar, kontraktori nuk do të marrë pagesë paraprake.
- 10.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda _____ ditëve nga marrja e sigurimit të kontratës.
- 10.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet kontraktorit sipas formulës së mëposhtme: _____
- _____

Neni 11. Shërbimet në Lidhje me to

- 11.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagës së shërbimeve të lidhura



TIRANË ALBANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUJË

Neni 12. Zbritja e garancisë së kontratës

12.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

INVESTITORI

BASHKIA KRUJË

Kryetari

Z, Artur BUSHI



SIPËRMARRESI


BASHKIMI I OPERATOREVE EKONOMIK

“Regli”sh.p.k dhe “Agi Kons” sh.p.k

Administratori

Z, Njazi Prënci

Sh.p.k.
CEL.0672028399
TIRANË - ALBANIA



Administratori

Z, Alban Cihari

KONS
-P.K
TIRANË - ALBANIA

